

KOHEZIONI LEKSIKOR NË KAPITULLIN “TRASHJA” TË ROMANIT “VDEKJA MË VJEN PREJ SYVE TË TILLË” TË REXHEP QOSJES

Nertila RAMADANI, Lindita SKENDERI

Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Fakulteti Filologjik

*Corresponding author e-mail: nertila.ramadani@unite.edu.mk; lindita.skenderi@unite.edu.mk

Abstrakt

Kohezioni leksikor është thelbësor për ndërtimin e koherencës dhe kuptimit të teksteve letrare. Ai përfshin lidhjet gramatikore dhe leksikore që mbajnë një tekst të bashkuar në nivel sipërfaqësor. Analiza e kohezionit leksikor në tregimet e shkurtra është e rëndësishme, sepse shpesh hasen vështirësi në kuptimin e fjalëve dhe strukturës së tekstit.

Ky studim përqendrohet në analizën e kohezionit leksikor në tregimin e shkurtër “Trashja” të romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qosjes, për të zbuluar mënyrat si ky element kontribuon në ndërtimin e kuptimit, krijimin e veçanësisë stilistikore dhe emocionale. Të dhënat për këtë studim u mbledhën përmes metodës së hulumtimit në bibliotekë dhe u analizuan në mënyrë cilësore dhe sasiore. Kjo e fundit nënkupton kategorizimin e llojeve të kohezionit leksikor, duke u mbështetur në kornizën e propozuar nga Halliday dhe Hasan në librin e tyre *Cohesion in English* (1976), si dhe në teoritë mbështetëse nga David Nunan në *Introducing Discourse Analysis* (1993). Përmes analizës së kapitullit “Trashja”, studimi zbulon se përsëritja është mjeti më i përdorur, duke ndihmuar në përfundimin e mesazheve kyçe dhe në krijimin e një ritmi të qëndrueshëm në narrativë. Gjithashtu, përdorimi i sinonimeve dhe antonimeve pasuron kuptimin e tekstit duke krijuar kontraste dhe ngjashmëri.

Përmes përdorimit me mjeshtëri të kohezionit leksikor, Rexhep Qosja arrin të transmetojë një mesazh të fuqishëm social dhe kritik ndaj shoqërisë patriarkale dhe paragjyqimeve që ajo kultivon.

Fjalët kyçe: kohezioni leksikor, analizë letrare, Trashja, Rexhep Qosja, narrativë

1. Hyrje

Gjatë leximit të një pasazhi, i cili përbëhet nga më shumë se një fjali, çdo folës i gjuhës shqipe mund të dallojë nëse ai është një tërësi e lidhur apo thjesht një varg fjalish të palidhura. Teksti është një njësi gjuhësore që përdoret për të krijuar kuptim. Ai është një strukturë që përbëhet nga fjalë, fraza dhe fjali të lidhura, të cilat bashkë krijojnë një tërësi kuptimore që mund të kuptohet dhe interpretohet nga folësit e gjuhës. Fjala “tekst” përdoret në gjuhësi për t’iu referuar çdo pasazhi të folur apo të shkruar, pavarësisht nga gjatësia, që përbën një tërësi të unifikuar (Halliday dhe Hasan, 1976:1). Teksti karakterizohet nga koherenca dhe kohezioni, të cilat janë elemente të pranishme në çdo gjuhë dhe që lidhin pjesë të ndryshme të tekstit me njëra-tjetrën. Përmes këtyre elementeve, teksti përcjell kuptimin e tij në varësi të kontekstit dhe ndërveprimit midis pjesëmarrësve.

Kohezioni leksikor është thelbësor për ndërtimin e koherencës dhe kuptimit të teksteve letrare. Ai përfshin lidhjet gramatikore dhe leksikore që mbajnë një tekst të bashkuar në nivel sipërfaqësor. Këto lidhje krijojnë marrëdhënie midis fjalëve, fjalive dhe paragrafëve, duke siguruar një rrjedhë të qetë dhe logjike të tekstit. Një nga autorët që në letërsinë shqipe i përdor me mjeshtëri këto mjete leksikore për të ndihmuar në krijimin e një rrjedhe narrative të qëndrueshme dhe të pasur është Rexhep Qosja, në romanin e tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”.

Analiza e kohezionit leksikor në tregimet e shkurtra është e rëndësishme, sepse shpesh hasen vështirësi në kuptimin e fjalëve dhe strukturës së tekstit. Për të përcaktuar koherencën, strukturën e diskursit dhe kuptimin më të gjerë të tekstit në tregimin e shkurtër, është shumë e rëndësishme të kuptohet kohezioni leksikor i përdorur. Prandaj, ky studim përqendrohet në analizën e kohezionit leksikor në tregimin e shkurtër (kapitullin) “Trashja” të romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qosjes, për të zbuluar mënyrat si ky element kontribuon në ndërtimin e kuptimit, krijimin e veçanësisë stilistikore dhe emocionale.

Bazuar në atë që u tha më sipër, problemet e hulumtimit janë:

1. Cilat lloje dhe përdorime të kohezionit leksikor hasen në tregimin *Trashja* nga Rexhep Qosja?
2. Çfarë kohezioni leksikor shfaqet në tregimin *Trashja*?

Qëllimet e studimit janë:

1. Të identifikohen llojet dhe përdorimet e kohezionit leksikor të përdorura në tregimin *Trashja*.
2. Të identifikohen rastet e shfaqjes së kohezionit leksikor në tregimin *Trashja*.

Qëllimi i hulumtimit është theksimi i rolit të kohezionit leksikor si një mjet i domosdoshëm për ndërtimin e një teksti të mirëfilltë dhe të kuptueshëm si dhe të ofrojë një vështrim të ri mbi mënyrën se si Qosja i përdor këto mjete për të forcuar mesazhin e tij dhe për të pasuruar përvojën e lexuesve.

2. Metodologjia:

Të dhënat për këtë studim u mblodhën përmes metodës së hulumtimit në bibliotekë dhe u analizuan në mënyrë cilësore dhe sasiore. Procesi i analizës ka përfshirë disa hapa të rëndësishëm: Hapi i parë përfshin leximin me kujdes të tregimit *Trashja*, për të kuptuar përmbajtjen e tij. Hapi tjetër lidhet me identifikimin dhe shënimin e fjalëve që u përkisnin kategorive të kohezionit leksikor: përsëritjes, kolokacionit, sinonimisë. Hapi i tretë, që përfshin analizën sasiore, paraqet kategorizimin e llojeve të kohezionit leksikor, duke u mbështetur në kornizën e propozuar nga Halliday dhe Hasan në librin e tyre *Cohesion in English* (1976), si dhe në teorinë mbështetëse nga David Nunan në *Introducing Discourse Analysis* (1993). Pas këtij kategorizimi, u dokumentuan rastet e kohezionit leksikor brenda tregimit të shkurtër, ndërsa rezultatet u paraqitën në mënyrë përshkruese dhe analitike me shembuj konkretë.

Kjo qasje sistematike mundësoi një shqyrtim të detajuar të mënyrës se si kohezioni leksikor funksionon në narrativë, duke ofruar njohuri mbi rolin e tij në përmirësimin e koherencës dhe kuptimit të përgjithshëm të tekstit.

3. Kohezioni leksikor

Konceptet më të shpeshta, që përmenden si veçoritë kryesore të tekstit janë koherenca dhe kohezioni. Këto veçori lidhen drejtpërdrejt me “trupin e tekstit”, ndërsa tiparet tjera kanë të bëjnë me kontekstin dhe pjesëmarrësit. Trask (Trask, 1999:52) e përkufizon kohezionin si “praninë e lidhjeve të drejtpërdrejta gjuhësore që mundësojnë krijimin e një strukture në diskurs”, ndërsa koherencën (Trask, 1999:52) si “shkallën e ‘kuptimshmërisë’ që ka një diskurs në raport me njohuritë tona për botën”.

Halliday dhe Hasan (Halliday&Hasan, 1976:4), të cilët futën termin “kohezion” në gjuhësinë e tekstit, e përkufizojnë kohezionin si “një grup mundësish që ekzistojnë në gjuhë për ta mbajtur tekstin të lidhur, duke treguar vazhdimësinë që ekziston midis pjesëve të tekstit”. Sipas tyre teorikisht ekzistojnë dy lloje kohezioni: gramatikor dhe leksikor, që do të thotë se brenda tekstit ai mund të realizohet përmes lidhjeve gramatikore dhe leksikore.

Sipas mënyrës së krijimit të lidhjeve brenda tekstit ekzistojnë pesë lloje kohezioni. Këtu përfshihen: referenca (ang. reference), zëvendësimi (ang. substitution), elipsi (ang. ellipsis), lidhëzat (ang. conjunction) dhe kohezioni leksikor (ang. lexical cohesion). Tre të parat i përkasin kohezionit gramatikor, ndërsa lidhëzat paraqesin një simbiozë të gërshetuar leksiko-gramatikore. Këto lloje funksionojnë në mënyrë të veçantë dhe mundësojnë lidhjen e fjalive dhe paragrafëve, duke e bërë tekstin koheziv.

Kohezioni leksikor është një aspekt i rëndësishëm i koherencës së tekstit që përfshin përdorimin e fjalorit për të lidhur pjesë të ndryshme të një teksti përmes zgjedhjes së kujdesshme të fjalëve dhe marrëdhënieve semantike. Ai përfshin teknika të ndryshme, duke që përfshijnë ribërjen dhe kolokacionin, të cilat ndihmojnë në krijimin e lidhjeve kuptimore midis fjalëve dhe frazave. Ai përfshin lidhjet kohezive që krijohen përmes përdorimeve të ndryshme leksikore: përsëritja e fjalëve, sinonimet, antonimet, hiponimet, fjalët përplotësuese etj. Koncepti i kohezionit leksikor, si një nga mjetet kohezive, duhet të zotërohet plotësisht për të interpretuar saktë kuptimin e një lekseme në tekst.

4. Analiza e tregimit të shkurtër

Tregimi i shkurtër është një formë e shkrimit gjuhësor që përfaqëson një vepër të shkurtër fiktive. Ai ka temën e zhvilluar plotësisht, por është shumë më i shkurtër dhe më pak i ndërlikuar se romani.

Tregimi (kapitulli) *Trashja* i Rexhep Qosjes paraqet një rrëfim emocional dhe simbolik, që hedh dritë mbi jetën e një gruaje të prekur nga një seri sfidash emocionale dhe shoqërore. Rrëfimi ndjek linjën e udhëtimit të saj që nga përjashtimi shoqëror deri te vdekja e dhunshme. Trashja, personazhi kryesor, jeton në një shoqëri që e diskrediton për pamjen e saj, duke e përjashtuar dhe trajtuar me dhunë, përfshirë edhe rrahjet nga njerëzit që supozohet të ishin mbështetje për të, si familja e saj. Përshkrimi i dhunës ndaj Trashes, paraqitet jo vetëm si veprim fizik, por edhe të mohimit dhe të përjashtimit të saj si individ (ato janë reflektim i qëndrimeve kolektive të një shoqërie patriarkale, në të cilën Trashja jeton). Ky trajtim i egër e i ashpër e bën Trashen të ndihet e izoluar, e pambrojtur dhe e braktisur, duke e thelluar ndjenjën e saj të pafuqisë dhe çmendurisë që ajo përjeton. Përsëritja e emrit të saj dhe frazave si “zogu në hava” flasin për izolimin e thellë emocional dhe ndjenjën e të qenit “ndryshe”. Kjo histori nuk është histori e vuajtjes individuale, por kritikë e ashpër e shoqërisë që i ndëshkon ata që nuk i përputhen normave të saj.

Një nga momentet më prekëse të romanit që rrëfen rreth gjendjes së saj është humbja tragjike e një fëmije, një ngjarje që ka lënë plagë të pashlyeshme në zemrën e saj dhe e ka shkatërruar emocionalisht. Kjo ngjarje tronditëse e ka shkatërruar shpirtërisht Trashen, duke e detyruar atë të përballet me dhimbjen dhe trishtimin që ajo ndjen çdo ditë. Humori i saj shpesh është i errët, ndërsa ajo përshkruhet si e mbyllur dhe e trishtuar. Kjo e bën atë të duket si një personazh i çmendur, por në të vërtetë, ajo është një viktimë e kushteve të ashpra që e rrethojnë.

Tregimi shqyrton thellësinë e ndjenjave të saj, duke e paraqitur Trashen si një simbol të vuajtjes njerëzore. Ajo është më shumë se thjesht një grua e çmendur; ajo është një njeri që përballet me trauma të thella dhe sfida shoqërore. Të tjerët e shohin atë si një objekt për tallje dhe përbuzje, por pak i kuptojnë vuajtjet e jetës së saj dhe arsytet që e kanë sjellë në këtë gjendje.

Nëpërmjet përshkrimeve të detajuara dhe ndjenjave të tensionuara, rrëfimi është më shumë se tregim për vuajtjen; ai është një thirrje për empati, një kujtesë për t'i kujtuar ata që shoqëria i ka mohuar. Përmes përvojës së Trashës, lexuesit mund të shohin pasojat e padrejtësive shoqërore, duke e bërë këtë tregim një reflektim të rëndësishëm mbi marrëdhëniet njerëzore.

5. Rezultatet e analizës së kohezionit leksikor në tregimin (kapitullin) “Trashja”

Vdekja është një temë që shpesh përsëritet në veprat e Qosjes, dhe “Trashja” mund të shihet si një reflektim mbi mortalitetin. Pësha që Trashja ndjen dhe e përjeton mund të simbolizojë praninë e pashmangshme të vdekjes—ndoshta jo domosdoshmërisht në mënyrë literale, por si diçka që akumulohet, grumbullohet dhe rëndon mbi jetën.

a) Përsëritja:

Halliday e konsideron përsëritjen si “formën më të drejtpërdrejtë të kohezionit” (Halliday, 2004:571). Përsëritja, si një figurë stilistike, shërben për të ndërtuar kohezion duke rifutur njësi leksikore, qoftë në trajtën origjinale apo të modifikuar, për shembull, përmes sinonimisë. Kjo figurë përdoret nga autori për të vënë në pah idetë kryesore dhe për të rritur ndikimin e argumenteve të tij. Përmes përsëritjes, autori zgjon emocione te lexuesit, duke ndikuar në perceptimet, qëndrimet apo bindjet e tyre.

Në tekstin që është shkëputur për analizë theksi vihet mbi përsëritjen e emrit Trashes, i cili është njëherit i vendosur edhe në titull, e është i përdorur më së shpeshti si trajtë e rasës emërore dhe kallëzore. Në të shumtën e rasteve është i përdorur i vetëm, por në fillim të tregimit shoqërohet me atributin e “Dervishit të Mukaillit”, si për të treguar pronësi e jo personalitet autonom.

“Shihej Trashja se ishte hidhëruar jashtëzakonisht shumë, megjithëse kishim menduar se barra e rëndë nuk do ta hidhëronte, dhe ishim kujdesur ta qetësonim, duke e ngarkuar edhe kësaj here. Kur nuk çonte drith në mulli, Trashja ngarkohej me dru të zjarrit, me të cilat nxehej tërë shtëpia dhe gatuheshin bukët, por edhe me gurë kur duhej të rrethohej avlia. ...Dhe atëherë nisej në rrugë dhe ne e dinim se Trashja ishte ndërsyer në krye dhe nuk do të kthehej për katër-pesë ditë. E dallonim Trashesin e mërzhitur për shkak se ecte më shpejt se zakonisht.....” (Qosja, 1976:26).

Emri “Trashes” në tekst është përsëritur gjithsej 71 herë. Përsëritja e vazhdueshme e këtij emri, e vendos atë si qendër narrative dhe emocionale të tregimit. Përmes kësaj përsëritjeje lexuesi e mban fokusin te personazhi kryesor.

Shprehjet e thëna nga goja e Trashes:

- Hë, hë, hë, zogu në hava, hë hë hë!
- Hë, hë, hë djali im, hë, hë, hë!

Këto fraza, të përsëritura 5 herë nga ana e Trashes (apo sa herë që ajo flet në tregim), përfaqësojnë një formë të përsëritjes dhe janë të rëndësishme për theksimin e emocionit dhe ritmit në narrativën e tregimit. Shprehja “zogu në hava” simbolizon izolimin dhe ndjenjën e ngushtësisë që Trashja e përjeton. Përsëritja e tingujve si “hë, hë, hë” ndihmon në krijimin e një atmosfere të çuditshme, duke pasqyruar ndjenjat e personazhit, që flet më tepër për natyrën e saj.

b) Sinonimet:

Kohezioni leksikor lidhet shpesh me sinoniminë (e cila përfshin përdorimin e termave me kuptime identike apo të ngjashme). Këto fjalë, duke qenë të lidhura nga pikëpamja kuptimore, përdoren për të arritur të njëjtin efekt dhe, duke shmangur përsëritjen e drejtpërdrejtë, i shtojnë shprehjes më shumë gjallëri dhe stil. Gjithashtu, sinonimia shërben për të theksuar dhe për të bërë më të qartë pjesën e tekstit që kërkon vëmendje më të madhe.

Trashja përshkruhet me terma të ndryshëm si **budallaqe, e marrë, e çmendur**, - sinonime që e përforcojnë idenë si e percepton shoqëria këtë personazh të marginalizuar.

Përdorimi i sinonimeve të fjalës “dhunë” si **rrahje, zullum, torturë**, tregojnë përmasën e gjerë të vuajtjeve të saj dhe krijojnë lidhje semantike brenda tekstit.

Sinonimet **të bërtitja, të çirresha** janë përdorur jo vetëm për të shprehur vuajtjen dhe mllëfin e grumbulluar, por edhe pamundësinë për të komunikuar me një shoqëri që e ka shtypur.

“Doja të bërtitja, të çirresha sa më te madhe që të më ndëgjonte kush prej burrave, grave apo fëmijëve” (Qosja, 1976:29)

Vargu i fjalëve të përafërta, **më të paqartë, më të fshehtë, më misterioze** krijon një gradacion stilistik, i cili rrit intensitetin emocional dhe ndjesinë e të panjohurës.

Po, mund të jetë se më kujtohet edhe për diçka tjetër, më të paqartë, më të fshehtë, më misterioze, që kurrësesi s'mund t'i bie në fije. (Qosja, 1976:17)

c) Antonimet:

Në tregim antonimet janë krijuar me mjeshtëri për të ndërtuar një lojë kuptimore mes të kundërtave, duke sjellë në pah përplasjet e forta mes dy botëve: brendësinë e trazuar të personazhit kryesor dhe shoqërisë së ashpër që e rrethon atë.

Kontrasti ndërmjet fjalëve “e ndyrë” dhe e “larë” në tekst nuk thekson vetëm ndryshimet fizike të jashtme të Trashes, por edhe ato sociale, sepse pastërtia reflektohet dhe perceptohet edhe si një simbol i moralit.

Antonimet “e marrë” dhe “e pafajshme” shprehin mënyrat e ndryshme të interpretimit të karakterit të Trashes: “e marrë” – nga shoqëria dhe “e pafajshme” – nga lexuesit.

“E qetë” dhe “e tërbuar” – ky çift antonimesh përshkruan ndryshimet ekstreme emocionale të Trashes gjatë zhvillimit të tregimit.

“Të bardhat” dhe “të zezat” – të përdorura në të njëjtën fjali, paraqesin një kontrast simbolik për të shpjeguar ndryshimet e jetës dhe fateve të njerëzve.

Trashja kishte lindur uqurzezë, se njeriut, shpeshë, me çastin e lindjes i fillojnë të bardhat ose të zezat e jetës. (Qosja, 1976:22)

d) Hiponimia:

Hiponimia përshkruan një lidhje hierarkike midis termave, në të cilat një fjalë e veçantë (hiponimi) përfshihet brenda kuptimit të një termi më të përgjithshëm (hiperonim). Për dallim nga marrëdhëniet e sinonimisë dhe përsëritjes, të cilat lidhen me të njëjtët referentë jashtëgjuhësorë, hiponimet dhe meronimet formojnë një kategori fjalësh që zakonisht varen nga një term bazë dhe lidhen me referentë të ndryshëm jashtëgjuhësorë.

Hiperonimi “familja” i lidhur me anëtarët e ngushtë të familjes: vëllezër, motra, xhaxhallarë, teze, halla.

Kishte tre vëllezër, katër motra, dy xhaxhallarë, dy teze e tri halla. (Qosja, 1976:22)

Fjalët hiponimike “molla”, “dardha”, “pjepri”, që i përkasin hiperonimit “frutat” janë përdorur për të bërë krahasime me pjesët e trupit të Trashes, për ta pasuruar përshkrimin e saj.

“Faculetë”, “thesi”, “leekat” janë hiponime të hiperonimit “rrobat” – të cilat tregojnë lloje të ndryshme veshjesh që Trashja i përdorte, të cilat njëherit reflektonin gjendjen e saj ekonomike dhe sociale.

e) Krahasimet:

Përmes krahasimit, autori ndihmon në theksimin e cilësive të veçanta të elementeve të tregimit dhe në ndërtimin e marrëdhënieve midis tyre, duke e bërë tekstin më të kuptueshëm dhe koherent për lexuesin. Krahasimi krijon lidhje logjike brenda tregimit, duke përforcuar kuptimin dhe efektin e tij letrar.

Krahasimet e figurës së Trashes bëhen me elemente nga jeta rurale dhe kafshët. Figurat e përdorura si: *thesi i mbushur me miell, këmbët si shtylla e Teqes së madhe, lopa e Canit, vënë*

në pah jo vetëm përmasat e saj fizike, por reflektojnë edhe mënyrën si shoqëria e dehumanizon dhe e përjashton atë, duke e tallur dhe paragjykuar.

“.... ishte e trashë, si thesi i mbushur me miell; i kishte këmbët si shtylla e Teqes së madhe, i kishte llërët më të trasha se qafa e buallicës së Makës; i kishte vithet e gjëra, si të mushkës së Ramizit të Nurës; i kishte cicat e mëdha si të lopës së Canit të Kastratit.” (Qosja, 1976:19-20)

Në paragrafë të tjerë, krahasimet e bukurisë dhe brishtësisë së saj bëhen përmes elementeve natyrore:

“Ajo na i paskësh kofshët si dëbora të bardha dhe si dardha të forta; ajo na i paskësh gjinjtë e plotë, të njomë si molla e pjekur; ajo na i paskësh buzët e ëmbla si sheqeri i Shkodrës; ajo na e paskësh barkun e ardhur si fletët e pjeprit; ajo na qenkësh e nxehtë si furra e Hajros së Boshnjakut”. (Qosja, 1976:21)

Krahasimet në tregim mund të vërehen edhe në formë jo të drejtpërdrejtë, implicite. Në këtë mënyrë personazhi kryesor përshkruhet duke përdorur figurën e simbolit, si: *guacë e mbyllur deti, breshkë e tërhequr, ulkonjë e plagosur*. Këto simbole tregojnë mbrojtjen e brishtë, frikën dhe nevojën për mbyllje për t’u mbrojtur nga dëmtimet e jashtme si dhe mungesën e një rrugëdaljeje për të trajtuar plagët e saj.

“Ishte një guacë e mbyllur deti, të cilën mund ta çelish vetëm po ta thesh; ishte një breshkë e tërhequr nën samarin e vet, të cilën mund ta nxjerrish vetëm po ta përgjakish; ishte një ulkonjë e plagosur, së cilës ia qetëson plagët vetëm me plumb.” (Qosja, 1976:27)

Tabela .1: Llojet e kohezionit leksikor të përfaqësuara në tregimin “Trashja”		
Lloji i kohezionit leksikor	Përshkrimi	Shembuj nga teksti
Përsëritja	Përsëritja e emrit “Trashja”, frazave “zogu në hava” dhe termave që lidhen me dhunën dhe mjerimin.	“Trashja”; “zogu në hava”; “rrahjet”
Sinonimia	Sinonimet: “budallaqe” – “e marrë” - “e çmendur” “zullum” – “torturë” – “dhunë”	“budallaqe” ; “e marrë” ; “e çmendur” ; “zullum”
Antonimia	Antonimet: “e ndyrë” – “e larë”; “e marrë” - “e pafajshme”	“e ndyrë” dhe “e larë”; “e marrë” dhe “e pafajshme”
Hiponimia	Hiperonimi “rrobat”: hiponimet “Faculetë”, “thesi”, “lecat”. Hiperonimi “frutat”: hiponimet “molla”, “dardha”, “pjepri”. Hiperonimi “familja”: hiponimet: vëllezër, motra, xhaxhallarë, teze, halla	
Marrëdhëniet e vazhdimësisë (meronimia)	Përshkrimi i pjesëve të Trupit të Trashes (koka, flokët, buzët); si dhe të ambientit (shtëpia, livadhi, rruga, kodra)- që simbolizojnë jo vetëm vendin ku ajo kërkon	koka, flokët, buzët shtëpia, livadhi i Mulla Jusufit, rruga.

	strehim, por edhe distancën nga bota njerëzore.	
Komplementariteti	Lidhjet dyshe: burrat dhe gratë, dhunuesit dhe viktimat (për të ndërtuar tension dhe marrëdhënie shoqërore).	burrat dhe gratë; dhunuesit dhe viktimat
Bashkërendimi (Kolokacioni)	Shprehjet: lecka, varfëri, rrahje, zogu në hava për të krijuar një rrjet semantik të fuqishëm	lecka, varfëri, rrahje, zogu në hava
Krahasimet	E përshkruajnë Trashen përmes lidhjeve me natyrën dhe jetën e përditshme.	E trashë si thesi i mbushur me miell Këmbët si shtylla e Teqes së madhe Llërët më të trasha se qafa e buallicës së Makës Vithet e gjëra si të mushkës së Ramizit të Nurës Cicat e mëdha si të lopës së Canit të Kastratit Kofshët si dëbora të bardha si dardha të forta Gjinjtë e plotë, të njomë si molla e pjekur Buzët e ëmbla si sheqeri i Shkodrës Barkun e ardhur si fletët e pjeprit E nxehtë si furra e Hajros së Boshnjakut

Në tabelën nr. 1 është dhënë një pasqyrë e përgjithshme e mënyrave si elementi gjuhësor lidhet dhe kontribuon në krijimin e koherencës dhe narracionin e tregimit. Përsëritjet e shpeshta të emërtimeve dhe frazave krijojnë idenë e përsëritjes së situatave dhe ngjarjeve. Sinonimet dhe antonimet përdoren për të krijuar ngjashmëritë dhe kontrastet e personazhit me situatat, ndërsa hiponimia dhe meronimia japin ndihmesë në portretizimin e hollësishëm të personazhit kryesor dhe hapësirës ku ajo jeton dhe e përshkon. Në tekst gjithashtu janë të rëndësishme edhe krahasimet, që janë të mëdha në numër, sepse krijojnë imazhe të fuqishme dhe kontraste pamore që theksojnë karakteristikat fizike të Trashes.

6. Përfundimi

Analiza e kohezionit leksikor në tregimin “Trashja” të romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qosjes mundëson kuptimin e shprehjeve dhe qasjeve leksikore të përdorura nga autori. Si element kyç në strukturën e tekstit, kohezioni leksikor luan rol në ndërtimin e kuptimit dhe mesazhit të tregimit, duke i lidhur elementet e tij në një tërësi të plotë.

Një nga aspektet më të fuqishme të kohezionit leksikor është përsëritja e emrit të personazhit kryesor “Trashja”, që e pozicionon atë si qendër dhe strumbullar simbolik, drejt të cilit është i orientuar i gjithë rrëfimi i tregimit. Kjo përsëritje e vazhdueshme sjell në fokus të pandërprerë imazhin e saj para syve të lexuesit.

Sinonimet dhe antonimet përforcojnë kontrastet dhe ndërtimin kuptimor të tregimit duke paraqitur dallimet mes perceptimit të shoqërisë dhe realitetit të brendshëm të personazhit. Antonimet si “e ndyrë” dhe “e larë” apo “e qetë” dhe “e tërbuar”, jo vetëm që theksojnë ndryshimet emocionale dhe fizike të personazhit, por njëherit japin pasqyrë të qartë të realiteteve të kundërta me të cilat ajo përballlet.

Tjetër aspekt i rëndësishëm i kohezionit leksikor që doli në pah ishin hiponimia dhe meronimia, që përdoren për të portretizuar jo vetëm personazhin kryesor, por edhe ambientin ku realizohet tregimi. Krahasimet e shumta me elemente të jetës rurale dhe natyrës e bëjnë tregimin e pasur dhe të fuqishëm.

Përmes përdorimit me mjeshtëri të kohezionit leksikor, Rexhep Qosja arrin të transmetojë një mesazh të fuqishëm social dhe kritik ndaj shoqërisë patriarkale dhe paragjytimeve që ajo kultivon. Trashja nuk është vetëm viktimitë individuale. Trashja i përfaqëson të gjitha ato që nuk iu përputhën normave të pranura shoqërore, është simbol i gjendjes së përjashtimit dhe të izolimit që mund të përjetojnë.

Thënë në përgjithësi, kohezioni leksikor në këtë tregim është mjet i fuqishëm për të thelluar ndikimin emocional dhe për të transmetuar një mesazh shoqëror që mbetet aktual edhe sot. Ky tregim me narrativen e tij unike dhe gjuhën e pasur, na kujton fuqinë e letërsisë për të ndikuar dhe frymëzuar në mënyrë të pashlyeshme.

Referencat

- [1] Antari, N. M. S., & Mulyawan, I. W. (2017). Lexical cohesion found in "The Tell-Tale Heart" by Edgar Allan Poe. *HUMANIS*, 18(1). Retrieved from <http://ojs.unud.ac.id/index.php/sastra/article/download/27153/17191>
- [2] Hadidi, Y., & Nazerfar, R. (2018). Comments on the system of lexical cohesion in a sample of English fiction. *International Journal of Linguistics and Literature*, 3.
- [3] Halliday, M. A. K., & Hasan, R. (1976). *Cohesion in English*. London: Longman Group Ltd.
- [4] Halliday, M. A. K., & Matthiessen, C. M. I. M. (2004). *An introduction to functional grammar* (3rd ed.). University of Sydney, Australia.
- [5] Kafes, H. (2012). Lexical cohesion: An issue only in the foreign language? *English Language Teaching*, 5(3). <https://doi.org/10.5539/elt.v5n3p83>
- [6] Mulović, A. (2023). Mechanisms of lexical cohesion in Arabic political discourse. *Context Journal of Interdisciplinary Studies*, 10(2). <https://doi.org/10.55425/23036966.2023.10.2.7>
- [7] Nunan, D. (1993). *Introducing discourse analysis*. England: Penguin Books.
- [8] Qosja, R. (1976). *Vdekja më vjen prej syve të tillë*. Prishtinë: Rilindja.
- [9] Trask, R. L. (1999). *Key concepts in language and linguistics*. Psychology Press.
- [10] Van Dijk, T. A. (2008). *Discourse and context: A sociocognitive approach*.
- [11] Van Dijk, T. A. (2019). *Macrostructures: An interdisciplinary study of global structures in discourse, interaction, and cognition*.
- [12] Williams, L. (2010). *Pragmatics and discourse: A resource book for students* (2nd ed.) by Cutting, Joan. *Modern Language Journal*, 94(2), 347–348. <https://doi.org/10.1111/j.1540-4781.2010.01031.x>